



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2065, datë 14.06.2012

Për

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1871, datë 11.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë, midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Altelecom sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 14.06.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbyllja e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1871, datë 11.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë, midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Altelecom sh.a.”,

të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (*Raporti*);

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku”, Nr. 43, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571

Fax : + 355 4 2259 106

www.akep.al

info@akep.al

- Projekt Vendim i KD (*Projekt Akti*);
- Dokumentet shkresore të palëve (*Provat, Pretendimet*);

BAZA LIGJORE:

1. 1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Vendimin nr. 1871, datë 11.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë, midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”;
- Shkresën nr. 2492Prot., datë 26.4.2012 (nr. 824Prot. i AKEP, datë 26.4.2012) “Shpjegimet e Abissnet sh.a. lidhur me mosmarrëveshjen e interkoneksionit me Albtelecom sh.a.”;
- Shkresën nr. 2259Prot., datë 4.5.2012, (nr. 417/6Prot. i AKEP, datë 7.5.2012) “Mbi depozitimin e pretendimeve të Albtelecom në zbatim të vendimit nr. 1871, datë 11.4.2012, lidhur me procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Abissnet sh.a.”;
- Shkresën nr. 2263Prot., datë 7.5.2012, (nr. 893Prot., datë 7.5.2012) “Njoftim për shkelje” drejtuar Abissnet sh.a., si edhe,
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen si dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. AKEP me anë të Vendimit nr. 1871, datë 11.4.2012, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Altelecom sh.a.”, në pikat 1, 3 dhe 4 të tij ka vendosur:
- “Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Altelecom sh.a.”;
 - Të njoftohen palët e interesuara sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Altelecom sh.a., për fillimin e procedimit administrativ;
 - Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;
- II. Abissnet sh.a., me shkresën nr. 2492Prot., datë 26.4.2012 (nr. 824Prot. i AKEP, datë 26.4.2012) “Shpjegimet e Abissnet sh.a. lidhur me mosmarrëveshjen e interkoneksionit me Altelecom sh.a.” sqaron si më poshtë:

Abissnet sh.a., ka paraqitur kërkesë për lidhje marrëveshje interkoneksioni për shërbimet e thirrjes me kartë telefonike Altelecom sh.a.

Abissnet është njoftuar nga Altelecom sh.a. për draft marrëveshjen e re të interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë si vijon:

1. Në aneksin nr. 4, të draft MI të shërbimeve të thirrjes me kartë, pika I.2, “Tarifa për shërbimet e aksesit në pikën e akses interkoneksionit” fq. 37 është parashikuar detyrimi për Abissnet, për të paguar një tarifë (qira) mujore prej 20 000 lekë/muaj për çdo sistem E1;

Ky detyrim është i papranueshëm nga Abissnet, duke qenë se Abissnet ka investuar duke përballuar koston e instalimit dhe duke kryer të gjitha punimet e nevojshme për realizimin e instalimit të qarkut E1. Për realizimin e shërbimit të interkoneksionit të shërbimeve me kartë shfrytëzohet infrastruktura e Abissnet;

Zbatimi i tarifës së lartpërmendur e vendos shoqërinë Abissnet në pozita diskriminuese në raport me Altelecom, duke detyruar të konkurojë në një treg me kushte jo të barabarta, si edhe bie në kundërshtim me nenin 39 të ligjit 9918.

Është e vërtetë se qarku E1 përdoret nga Abissnet por Altelecom nga ana tjetër përfitonte tarifë për thirrje dhe tarifë për minutë. Altelecom pretendon se tarifa prej 20 000 lekë/muaj për çdo sistem E1 është në kuadër të mirëmbajtjes së sistemit E1 dhe portës E1 të vendosur në centralin e Altelecom. Nga ana tjetër edhe Abissnet kryen mirëmbajtjen e sistemit E1 dhe portës E1 të vendosur në centralin e Abissnet.

Fakti që kjo tarifë është paguar më parë nga Abissnet, nuk do të thotë se është pranuar si tarifë e drejtë. Kjo tarifë mujore është paguar pasi Abissnet ka qenë i

interesuar për ofrimin e shërbimit të thirrjes me kartë dhe për Albtelecom kushtet e MI për shërbimin e thirrjes me kartë kanë qenë të panegociueshme.

2. Në draft marrëveshjen interkoneksionit, neni 14, pika 5, parashikohet: “Nëse operatori i thirrjes me kartë nuk kryen pagesat brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, atëhere do të aplikohet kamatvonesë në masën 0.5 % të vlerës së shumës së detyruar për çdo ditë kalendarike që tejkalohet ky afat, po jo më shumë se 10 ditë në vijim”.

Kamatvonesa prej 0.5 %, është 15 herë më e lartë se interesat bankare që zbatojnë bankat e nivelit të dytë në Shqipëri, pra është e papranueshme për Abissnet. Gjithashtu, bie në kundërshtim edhe me vendimin unifikues nr. 932. datë 22.6.2000, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Abissnet sh.a., kërkon nga AKEP të vendosë për:

Ndryshimin e ORI dhe draft Marrëveshjes së Interkoneksionit të shërbimeve të thirrjes me kartë të Albtelecom sh.a., duke vendosur heqjen e tarifës mujore prej 20 000 lekë për cdo sistem E1 dhe, mosaplikimin e kamatvonesës në vlerën 0.5 % por në nivele me të ulëta.

III. Albtelecom sh.a., ka sjellë pretendimet me shkresën nr. 2259Prot., datë 4.5.2012, (nr. 417/6Prot. i AKEP, datë 7.5.2012) “Mbi depozitimin e pretendimeve të Albtelecom në zbatim të vendimit nr. 1871, datë 11.4.2012, lidhur me procedimin administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Abissnet sh.a.”. Bëjmë me dije se, këto pretendime nga Albtelecom sh.a., janë sjellë jashtë afatit prej 15 ditësh sipas pikës 4, të Vendimit nr. 1871, datë 11.4.2012.

Albtelecom, në këto pretendime (të cilat janë të njëjta me ato të shprehura edhe në takimin e mbajtur mes palëve në AKEP gjatë seancës paraprake të datës 26.3.2012) sqaron se:

Tarifa prej 20 000 lekë për portën e aksesit është tarifë jo nën rregullim dhe e parashikuar në marrëveshjen për akses e interkoneksion për ofrimin e shërbimit të thirrjes me kartë që në vitin 2009. Kjo tarifë është aplikuar për të gjithë operatorët që lidhin MI për ofrimin e shërbimit të thirrjes me kartë, duke zbatuar detyrimin për mosdiskriminim.

Albtelecom sqaron gjithashtu se kjo tarifë është paguar rregullisht si nga Abissnet ashtu edhe nga operatorët e tjerë që prej vitit 2009, kohë kur kjo tarifë është vendosur për herë të parë.

Kjo tarifë është vendosur në përputhje me natyrën dhe specifikat e këtij shërbimi, për aksesin që ofron Albtelecom në rrjetin e tij, për këto sipërmarrës të OSHKP duke i mundësuar pajtimtarëve të Albtelecom aksesin drejt kodit të shkurtër të KPP për kryerjen e thirrjeve dalëse nëpërmjet platformës së ofruesit të këtij shërbimi. Në këtë mënyrë Albtelecom përmbush detyrimin ligjor për ofrimin të aksesit dhe nuk ka përfitime të drejtpërdrejta pasi ofruesit e këtij shërbimi konkurojnë drejtpërdrejt Albtelecom në tregun e thirrjeve me pakicë.

Në njoftimin e nëntorit 2011, për MI e re të aksesit për KPP, Albtelecom i ka kërkuar Abissnet edhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke e sqaruar se bazuar ne RIO, mosshlyerja e detyrimeve të prapambetura i jep të drejtë Albtelecom për të mosrinovuar MI e aksesit për KPP dhe pezullimin e shërbimeve. Në lidhje me kundërshtimet e Abissnet për draft MI e aksesit të janarit 2012, Albtelecom ka dhënë sqarimet zyrtare.

Aktualisht, Albtelecom vijon me ofrimin e shërbimeve të akses/interkoneksionit, megjithësej pa MI të nëshkruar mes palëve prej mëse 6 muajve, dhe në mungesë të garancisë financiare nga Abissnet.

Albtelecom shpjegon se Abissnet përveç detyrimeve ekzistuese lidhur me kamatvonesat, nuk ka paguar as detyrimet e muajve janar dhe shkurt 2012.

Albtelecom, kërkon nga AKEP, që bazuar në nenin 60 të ligjit 9918, të urdhërojë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të Abissnet ndaj Albtelecom dhe nënshkrimin e marrëveshjes së re për akses/interkoneksion duke depozituar edhe garancinë financiare.

Gjithashtu, Albtelecom sh.a., me shkresën nr. 2263Prot., datë 7.5.2012, (nr. 893Prot., datë 7.5.2012) “Njoftim për shkelje” drejtuar Abissnet sh.a., e njofton për detyrime të papaguara për muajt janar – shkurt 2012, për shërbimet e akses/interkoneksionit sipas marrëveshjes nr. 3222, datë 29.4.2009.

IV. AKEP, sa më sipër parashtroi, për çështjet objekt të kësaj mosmarrëveshje pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a., arsyeton si më poshtë:

- Për sa i takon çështjes së kamatvonesës në masën 0.5%, të vlerës së shumës së detyruar për çdo ditë kalendarike që tejkalohet ky afat, por jo më shumë se për 10 ditë në vijim, AKEP, duke iu referuar edhe vendimit nr. Nr. 1699, datë 20.10.2011, për “Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1653, datë 18.07.2011, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Abissnet sh.a dhe Albtelecom sh.a.”, mban të njëjtin qëndrim, edhe në këtë rast, pra duke mosndryshuar përcaktimet për kamat-vonesën. Përcaktimet përmabjnë edhe një limit për vlerën e kamat-vonesës cka është e arsyeshme.
- Për sa i takon çështjes së qirasë mujore prej 20 000 Lekë, për çdo sistem 2Mbit/s (E1):
 - o kjo tarifë ka qënë aplikuar më parë që prej 2009 dhe paguhet edhe nga operatorët e tjerë të kartave me parapagim, dhe në këtë kontekst nuk ka diskriminim midis këtyre operatorëve;
 - o AKEP nuk ka miratuar këtë tarifë duke e lënë komerciale midis palëve të përcaktojnë aplikimin ose jo apo nivelin e saj. Tarifa është aplikuar që nga vitit 2009 dhe palët (Abissnet dhe operatorët e tjerë OSHKP) nuk kanë pasur probleme me aplikimin e kësaj tarife, përfshirë nivelin

e saj. Abissnet nuk ka dhënë argumentat të mjaftueshme për mosvazhdimin e aplikimit të kësaj tarife.

- Për sa më sipër AKEP gjykon të mos ndërhyjë për ndryshime në aplikimin e tarifës mujore për E1 apo në nivelin e saj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimim administrativ të filluar me VKD nr. 1871, datë 10.4.2012, *“Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit për shërbimin e thirrjes me kartë midis sipërmarrësve Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a.”*.
2. Të mos pranojë kërkesat e Abissnet sh.a. për ndryshime në kamat-vonesën dhe aplikimin e tarifës mujore për E1.
3. Të njoftohen palët e interesuara Abissnet sh.a. dhe Albtelecom sh.a., për mbylljen e procedimit administrativ;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE